



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**KËSHILLI I BASHKISË**  
**KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK**

Nr. 132 / Prot.  
110

Patos, më 29/05 2023

**PROCESVERBALI I TAKIMIT 22 Maj 2024**

**Vendi:** "Salla e mbledhjes të Këshillit Bashkiak Patos"

**Ora e fillimit :** 10:00

**Ora e mbarimit :** 12:00

**Dëgjuesë publike me temë:** "Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025".

**Baza Ligjore:** Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

**Pjesëmarrës:** Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro, Keyetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, dhe rreth 40 pjesëmarrës (40 Banorë dhe Kryetarë të fshatrave të rrytetit Patos)

**Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj:**

**Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj:** Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 80, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025”. Siç e kemi thënë edhe më parë ne kemi një rregull për dëgjesat, gjithsecili para se të kërkoj fjalën duhet të prezantohet me emër, pasi takimi rregjistrohet dhe çdo ankesë, propozim apo mendim i juaj do trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi. Edhe njëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen. Dëgjesën e deklaroj të hapur, i kaloj fjalën Kryetarit të Bashkisë z. Fation Duro.

	<p><b>Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj</b></p> <p><b>Dëgjesë publike me temë:</b></p> <p><b>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</b></p> <p><b>Maj 2024</b></p>
--	--


**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro:-** në radhë të parë më lejoni që t’ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ për buxhetin afatmesëm i cili kalon në disa etapa konsultimi deri në finalizimin e tij në fund të vitit.

Gjatë muajit prill 2024 me keni realizuar takimet të ngjashme për marrjen e kërkesave prioritare për buxhetin afatmesëm dhe sot jemi me rishqyrtimin e atyre kërkesave të prezantuara prej jush të

	<p><b>Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro</b></p> <p><b>Dëgjesë publike me temë:</b></p> <p><b>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</b></p> <p><b>Maj 2024</b></p>
---	--

cilat në mënyrë të përmbledhur kanë të bëjnë me: Investime të përqëndruara në infrastrukturën rrugore, bujqësore, dhe ujësjellës, investohet për shtrimin e rrugëve të brendshme me rërë bituminoze, shtrim të rrugëve të parcelave me zhavorr mali, sistemim të KUZ dhe KUB, përmirësimin e sistemit të ndricimit rrugor, vazhdim të procesit të azhornimit në të gjithë fshatrat e qytetit, ndërtimi i një tregu dhe mirëmbajtja e fasadave të pallateve. Në këto kërkesa që përmenda nuk janë futur kërkesat e të rinjëve të qytetit për të cilët ka patur edhe me ta gjatë muajit prill takim konsultativ. Tani fjala është për ju nëse keni kërkesa të tjera për të shtuar ose nëse do të donit ndonjë orientim specifikisht lidhur mbi investimet e bashkisë.

**Banor i lagjen Naftëtari z. Sokrat Varfaj:-** unë dua t'ju falenderoj që na bëni pjesë e këtyre takimeve ku ne si banorë të qytetit të kemi mundësinë e ngritjes së problemeve tona jo personale por komunitare. Unë dua të vë theksin në disa problematika që më shqetësojnë si banor i Patosit dhe mendoj se është një shqetësim për të gjithë komunitetin, lidhur mbi varrezat publike dhe konkretisht mbi pastrimin e tyre edhe vendosjen e çezmave. Mendoj se duhet të ketë njëfarë rregullore për qytetarët në mënyrë mirëfunsonimin e qytetit, pra një rregullore për të gjithë qytetarët se si duhet të sillen në kmunitet dhe se si duhet të mbrojnë pronën publike, atë pronë që investohet nga bashkia nga taksat tona. Problem tjetër që ne hasim, është edhe rruga kryesore e qytetit e cila është një kalimshme edhe për mendimin tim përbën vështirësi dhe rrezikshmëri në



**Banor i lagjen Naftëtari  
z. Sokrat Varfaj**

**Dëgjese publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

lëvizjen e qetë të qytetarëve, gjithashtu te cirku të bëhën ndërhyrje nga ana e bashkisë. Kërkoj që nga ana e bashkisë të ketë një llojë kontrolli për cilësinë e ujit i cili shpërndahet me autobote, të ketë edhe autobote të posaçme si dhe një kontroll specifik lidhur mbi shpërndarjen e bukës pasi në gjykimin uji dhe buka janë të parat që duhet të kontrollohet për ruajtjen e shëndetit nga bashkia dhe shëndetësia m.q.se shoh se paska edhe përfaqësues të shëndetësisë . Një problem tjetër që dua të ngre është se nga ana e kompanisë Albpetrol në vitin 2018 janë hequr punonjës nga puna dhe

tani atje nuk ka më punonjës të kualifikuar pasi punonjësit më të vjetër dhe me eksperiencë pune u flakën në rrugë dhe askërkush nuk vuri dorë mbi ne naftëtarët e vjetër edhe pse Albpetroli akoma funksionon dhe merr punonjës të rinj përse nuk i merr miga qyteti jonë por punësohen nga qytetet e tjera.

**Banor i fshatit Grizë Lënginas z. Bardhyl Ruzhija:** Në fshatin Grizë ne kemi problem me rrugën e varrezave, rruga kryesore është bërë edhe për këtë ju falenderojmë, problem tjetër për ne është edhe ndriçimi i rrugëve të lagjeve pasi atje nuk ka ndriçim edhe është me rrezik për banorët kalimi natën në to. Problem tjetër që ne kemi janë sistemi edhe rregullimi i rrjetit KUZ, gjithashtu të shikohet edhe të pastrohet kanali te bonifikimi. Kanali te lagjja nuk është pastruar i gjithë pasi nga ndërmarrja pastrimi është bërë pjesërisht.



**Banor i fshatit Grizë Lënginas  
z. Bardhyl Ruzhija**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Kryetari i Bashkise z. Fation Duro:** pastërtia ka një problem te ju si lagjje pasi e gjithë lagjja juaj pjesa veriore e saj i hedh mbeturinat në kanal edhe jo në koshat që bashkia ju ka vendosur në dizpozicion, Ju informoj se koshat do të hiqen nga ai vend dhe javën tjetër do të shpërndahen koshat plastik për pjesën veriore të lagjjes dhe koshat do të jenë për çdo familje.



**Kryetari i Bashkise  
z.Fation Duro**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**


**Maj 2024**

**Banor i fshatit Grizë Lënginas z. Jonuz Metaj:** Në Grizë ju na kemi premtuar rrugën te Hangari por nuk ka filluar investimi ende, a mund ta di përse nuk ka filluar ky si investim? Gjithashtu rruga e lagjes për të cilën kemi diskutuar edhe më parë ka probleme pasi me rënien e shiut ajo është dëmtuar akoma edhe më shumë aq sa nuk arrinim të dilnim dot sepse nuk janë është bërë me kanalizimet e duhura. Mbi rrugët e parcelave, duhet të ndërhyrje pasi nuk shkojmë dot në tokat bujqësore. Problem tjetër madhor për ne si fshat është dhe mungesa e rrjetit të KUZ në të gjitha lagjet e fshatit.

	<p><b>Banor i lagjes Grizë Lënginas z. Jonuz Metaj</b></p> <p><b>Dëgjesë publike me temë:</b></p> <p><b>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</b></p> <p><b>Maj 2024</b></p>
--	--

**Kryetari i Bashkisë Fation Duro:** kam premtuar rrugën për te varrezat e cila është bërë brenda afateve të përcaktuara. Rrugët për në tokat bujqësore dhe në ullishte do të hapen së shpejti. Lidhur mbi problemin ngritur për mungesën e rrjetit KUZ është pak e vështirë momentalisht pasi përpara se të investojmë për KUZ si fillim do të bëjmë një studim të zonës me projekt të mirfilltë studimi, ndërsa rrugën për te hangari do ta shohim për ndonjë investim të mundshëm tani afër.

**Kryetari i fshatit Reres z. Shaban Ruçi:** në fshatin tonë ka disa probleme të cilat kanë nevojë për ndërhyrjen urgjente nga ana e bashkisë sic është thurja e varrezave me mur dhe vendosja e

	<p><b>Kryetari i fshatit Reres z. Shaban Ruçi</b></p> <p><b>Dëgjesë publike me temë:</b></p> <p><b>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</b></p> <p><b>Maj 2024</b></p>
---	---

çezmës në varrezat e fshatit. Rruga kryesore e fshatit, konkretisht rruga Patos- Patos lart e cila nuk është bërë asnjëhere edhe ka një nevojë emergjente për ndërhyrje. Ujërat e zeza janë lënë në lagjen Karemanaj pa u sistemuar. Rrugët e brendshme të fshatit janë të dëmtuara. Furgoni për transportin e udhëtarëve kur do të filloj pasi ne si banorë të kësaj lagje duhet të na jepet një zgjidhje. Lidhur mbi taksat e bashkisë, ato taksa që ne na kërkohen për të paguar si një detyrim ligjor, kërkojmë të na kthehen mbrapsht në investime si psh. Ndriçim, shtrim të rrugëve të lagjes.

**Banor i lagjes Grizë z. Isuf Bregu:** kanali në lagjen Grizë deri te Albpetroli nuk ka urë kalimi, kur është projektuar për tu bërë?



**Banor i lagjes Grizë  
z. Isuf Bregu**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Banore e lagjes 1 Maj znj. Rina Sholla:** Te varrezat publike të qytetit është një problem madhor lidhur mbi prezencën e inerteteve të cilat duhet të hiqen dhe të pastrohen nga punonjësit e agjencisë së shërbimeve pasi nuk shkojmë dot te të afërit tanë, gjithashtu të bëhet grafik për pastrimi i tyre nga barërat dhe nëse ka një të tillë ai të jetë më i shpeshtë.



**Banore e lagjes 1 Maj  
znj. Rina Sholla**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Kryetari i fshatit Dukas z. Ymi Myftaraj:-** Në fshatin Dukas ka një sërë problemesh, si ujrat e zeza në lagje, pusetat e dëmtuara, banesa e vjetra të cilat janë të mbuluara me internit që dihet se

është një material i dëmshëm për shëndetin, të shikohet mundësia për zëvendesimin e tyre me çati me anë të fondeve të bashkisë. Te liqeni në Dukas, të shikohet mundësia për rindërtimin e urës së kalimit, gjithashtu të shihet mundësia nga ana juaj për ndërtimin e banjove publike. Në fshatin Dukas një tjetër problem është konflikti i pronsisë. Te varrezat publike të shihet mundësia e bërjes së ndonjë çezme. Këtu te klubi i pensionistave janë bërë disa dëmtime dhe kërkoj që të shihet mundësia për tu rikostruktuar nga ana e bashkisë si dhe të shikohet mundësia për vendosjen e disa çadrave.



**Kryetari i fshatit Dukas  
z. Ylmi Myftaraj**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

**Banor i Naftëtari z. Daniel Shkokota:** duke ju falenderuar që më dhatë fjalën për të shprehur mendimin tim lidhur mbi disa shqetësime qytetare. Fjalën e parë e kam për këshilltarët të cilët duhet të jenë më të kujdeshshëm në marrjen e vendimeve pasi keni fatin e këtij qyteti në dorë për katër vjet. Rruga në lagjen 29 Marsi, konkretisht te shkolla Hekuran Maneku është bërë e pakalueshme dhe ka nevojë për ndërhyrje. Rruga kryesore është një mrekulli por kjo rrugë nuk ka tualete publike. Te arena e cirkut ka një problem madhor dhe kërkon ndërhyrje e gjithë ajo zona aty. Qeveria Shqipëtare ka një program mjaft të mirë për të tërhequr turistët e huaj dhe në vijimësi



**Banor i Naftëtari  
z. Daniel Shkokota**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

**Maj 2024**

të kësaj bashkia për gjykimin tim duhet të bëjë takim takim me emigrantët patosarakë edhe të ketë një plan konkret për risjelljen e tyre në këtë vend.

**Banor i lagjes 29 Marsi z. Bashkim Velçani:** Dua të falenderoj bashkinë për shtrimin e rrugëve, sjelljen e ujit të pijshëm, vendosjen e kamerave por prioritet për mua është: prona; Administratorët e pallateve dhe privatizimi i banesave para viteve 90.

	<p style="text-align: center;"><b>Banor i lagjes 29 Marsi z. Bashkim Velçani</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Dëgjesë publike me temë:</b></p> <p style="text-align: center;"><b>“Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Mai 2024</b></p>
---	--

**Kryetari i Bashkisë z. Fation Duro:** Rruga nga Albpetroli deri në fillim të lagjes do të bëhet brenda dhjetorit të këtij viti. Lidhur mbi problemet për varrezat publike ditën e premte do të realizohet një dëgjesë publike mbi mirëfunsonimin e varrezave publike në të gjithë territorin e bashkisë dhe njësive administrative ndaj ju ftoj ditën e premte të bëheni pjesë e këtij takimi konsultativ ku do të diskutojmë me detaje lidhur mbi rregulloren për shërbimin funeral por ajo mbetet për tu diskutuar ditën e premte. Qyteti i Patosit ka 47 parcela varrezash publike dhe në rreth 30 prej tyre do të ndërhyet për rrethimin duke përfshirë edhe vendosjen e ujit në parcela.

Lidhur mbi shqetësimin për punonjësit e Albpetrolit ai instiucion nuk është vetëm i bashkisë Patos edhe nuk është ekskuziviteti i bashkisë pavarsisht lokacionit të godinës së Albpetrolit, i cili është në territorin e bashkisë Patos. Rruga e varrezave në fshatin Grizë është ndërhyrë nga bashkia por ne do të ndërhyjmë edhe shtrimin e disa rrugëve me çakull

KUZ në fshatin Rerrës do ta shoh nga afër dhe do ta ndjek Rruga e “Xeballarët” mund të bëhet vitin tjetër. Rruga Rerës –Banaj nuk është më shumë e rëndësishme pasi ka rrugë të tjera të cilat e kanë më emergjente ndërhyrje. Të ish stallat e derrave do të ndërhyet për shtrimin e rrugës Rrugën në lagjen e “Kripallarëve” edhe urën te liqeni do ta shohim së bashku. Problemin që shtrove për ndërtimin e mureve banorët duhet të aplikojnë.

Për kalanë e Margëlliçit duhet ti drejtohem Ministrisë së Turizmit dhe monumenteve ndaj më lejoni t'ju falenderoj për mendimin për përthithjen e turistëve. Për buxhetin 2025-2027 është menduar që të ndërhyet në lagjen Naftëtari, e parafabrikatet do të planifikojmë projektin për rehabilitimin e zonës, shtrim të rrugëve në lagjen "29 marsi" pjesa e poshtme e unazës, ndërsa për rehabilitimin e fasadat e pallateve do të aplikohen përsëri. Rruga e Vreshtit përfundon këtë vit ndërsa prërroi do të bëhet me beton nga ura deri te fusha. Pjesa e poshtme e unazës dhe mbyllja e kanalit do të bëhet brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025. Në Grizë Lënginas do të shohim pjesën veriore për ndërhyrje.



**Kryetari i Bashkise  
z. Fation Duro**

**Dëgjese publike me temë:**

**"Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e "PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025".**

**Maj 2024**

**Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj:** Ju faleminderit Kryetar për informacionin e dhënë padiskutim që ne jemi në fazën e hartimit të buxhetit afatmesëm dhe për ti sqaruar edhe nje herë banorët jemi në fazat e konsultimit dhe padiskutim që deri në finalizimin e buxhetit mund të kemi ndryshime në varësi të kërkesave të qytetarëve. Edhe një herë ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj. Takimin e deklaroj të mbyllur

**Konceptoi:**

**Koordinator i Konsultimit Publik**

Suzana Hysenaj

**Pranoi: Sekretar i Këshillit**

Refaela Xeba

**Tema e Konsultimit: “Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e “PBA-së 2025-2027 dhe marrja e kërkesave buxhetore për vitin 2025”.**

